

Rregullimi i referendunit në Kosovë dhe krahasimi me shtetet e tjera

Mentori: Prof. Dr. Arsim Bajrami

Kandidati: Alban Miftari

Abstrakti

Referendumi paraqet një nga format më të drejtpërdrejta të demokracisë moderne, përmes tij sovranit merr fatin e një çështje për të vendosur vetë, duke ja marrë këtë të drejtë përfaqësuesve të zgjedhur. Kjo formë e demokracisë së drejtpërdrejtë aplikohet në shumë shtete demokratike, porse çdo shtet krijon një kufizim apo përkufizim të çështjeve që mund të jenë objekt i trajtimit në referendum, duke u njohur qytetarëve të drejtën për vetëvendosje në disa nga çështjet, kryesisht në çështje të rëndësishme apo jetike për shtetin dhe shoqërinë në përgjithësi. Kosova si një demokraci përgjithësisht e re, me një shtet ku të gjithë qytetarët janë pronarë të shtetit dhe me një shoqëri të ndërtuar në bazë të konceptit të bashkësisë multietnike njih të drejtën e referendunit, porse për shkak të kufizimeve që i janë mveshur kësaj të drejte, ende sot vazhdon të i mohohet të gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës e drejta për vetëvendosje përmes referendunit për çështje të cilat akti më i lartë juridik i shtetit ia njih këtë të drejtë. Duke konsideruar këtë çështje si një problematikë ndërmjet të drejtës së njohur dhe të drejtës së mohuar, kjo temë paraqet interes për tu hulumtuar dhe trajtuar, dhe atë pikësëpari përmes krahasimit me shtetet e tjera, e më pas edhe përmes trajtimit analitik e të thelluar të së drejtës për referendum në sistemin juridik të Republikës së Kosovës. Pavarësisht nga mos implementimi i kësaj të drejte, kjo e drejtë nuk mund të vazhdojë të jetë e mohuar, porse qytetarët e Kosovës në çdo kohë duhet të kërkojnë që sa më parë të vendoset baza ligjore, legale e procedurale për të lehtësuar zbatimin e referendunit si një e drejtë kushtetuese dhe si një mënyrë e ligjshme për vendimmarrje në Republikën e Kosovës.

Fjalë kyçe: referendumi, demokracia, sovraniteti, sistemi juridik.